

FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a dhe Komisionit të Prokurimit Publik

Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)

“Krijon” sh.p.k

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K12023001A

Nuis/Nipt

Rruga e Elbasanit, Nr. 57, Çollak, Tiranë

Adresa

Tiranë

Shqipëri

1044

Qyteti

Shteti

Kodi Postar / Posta

042340817

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

info@krijon.al

E-mail

Piro Zoga-Administrator

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2023/09/14

Data (viti/muaji/dita)

+355 4 234 0817

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)



Seksioni II. Informacion mbi procedurën

1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.

REF-79237-09-07-2023

2. Lloji i Procedurës

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.

- | | |
|--|---|
| Procedurë e hapur | Procedurë e hapur e thjeshtuar |
| <input type="checkbox"/> | <input checked="" type="checkbox"/> |
| Procedurë e kufizuar | Procedurë konkurruese me negociim |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Partneritet për inovacion | Dialog konkurrues |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit | Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës |
| <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| Shërbim Konsulence | |
| <input type="checkbox"/> | |
| Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP | |
| <input type="checkbox"/> | |

3. Autoriteti /Enti Kontraktor

Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.

Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a

4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

(Vlera e përlogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)

7.901.168,67 (Shtatë milion e nëntëqind e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.

5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër
(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).

“Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti”

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës
(Data (viti/muaji/dita)
2023/09/19

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit
(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)
N/A

8. Data e nënshkrimit të kontratës
(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavarshmëri të kontratës)
N/A

Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)
Ligji 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”
VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar
Vendim 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)

3. Rrethanat dhe faktet

Në datën 08.09.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar Mallra”, me numër reference REF-79237-09-07-2023 , me objekt “Blerje reagente pajisje laboratorit dhe impianti” me fond limit 7.901.168,67 (Shtatë milion e nëntëqind e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë presje gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH , dhe datë zhvillimi 19.09.2023 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Durres sh.a

Në Dokumentet Standarde të Tenderit, konstatoam disa parregullsi, kriteret e paqarta, si dhe të pajustificuara ligjërisht, të cilat nga njëra anë shkaktojnë konfuzion tek operatori ekonomik dhe nga ana tjetër kufizojnë artificialisht konkurrencën e lirë, duke zvogëluar mundësinë e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.

Së pari, referuar legjislacionit të prokurimit publik, Shoqëria “Krijon” sh.p.k ka “prima facie” interes për të paraqitur ankesë për këtë procedurë prokurimi, pasi është operator ekonomik i interesuar për të marrë pjesë në tender dhe paqartësitë e Dokumenteve të Tenderit çenojnë mundësinë tonë për sukses në procedurën e prokurimit.

Së dyti, referuar nenit 110 të LPP, pika 1 “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”, si dhe pika 8 “Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”, Shoqëria “Krijon” sh.p.k dërgon ankesën në përputhje me afatin e përcaktuar ligjor.

Së treti, bazuar në nenin 96 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pika 1 “Me marrjen e ankesës me shkrim nga ankimuesi, personi përgjegjës për prokurimin konfirmon në bazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik, nëse ankesa është paraqitur edhe pranë KPP-së.” Dhe neni 100 “Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.”, e dorëzojmë ankesën tonë, në respektim të kushteve formale të saj.

4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

1-Ne DST tek Kriteret e Vecanta te Kualifikimit pika 2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale është kërkuar:

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi /MAH/ ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregëtojë mallrat objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të jetë i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave dhe përfshirë afatin e zbatimit të kontratës.

Së pari kërkesa për autorizim është një kërkesë e pa argumentuar për këtë objekt prokurimi, pasi artikujt objekt tenderi janë materiale konsumi dhe aparate te vogla për të cilat nuk kanë nevojë për instalim dhe mirmbajtje dhe si rrjedhim nuk është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Së dyti, në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të vendosura nga autoriteti kontraktor nuk është argumentuar ligjerisht dhe teknikisht kërkesa e paraqitjes së autorizimit ku thuhet “*Autorizimi nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar për mallrat e ofertuara është një dokument i rëndësishëm i cili tregon aftësitë e operatorit ekonomik ofertues si dhe është një tregues cilësor i mallit që do të ofrohet. Në gjykim të autoritetit kontraktor, ky kriter është jo diskriminues, në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e operatorit ekonomik ofertues për aftësitë teknike*”.

Gjykojmë se argumentimi i mësipërm i kërkesës për autorizim nuk gjen mbështetje në LPP. Paraqitja e autorizimit jo vetëm që nuk është tregues i cilësisë së mallit që do të ofrohet, por edhe nuk tregon në mënyrë të drejtpërdrejtë aftësinë teknike të operatorit ekonomik pjesmarrës. Për të vërtetuar cilësinë dhe origjinalitetin e produkteve të ofruara në tender është katalogu i cili ka të pasqyruar artikullin, kompaninë prodhuese dhe detajimin e specifikimeve të ofertuara.

Së treti, pretendimi i autoritetit kontraktor se “*kërkesa për autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së operatorit ekonomik ofertues mbi përmbushjen me sukses të kontratës*” **bie ndesh me kërkesat e LPP,** i cili për të vërtetuar aftësinë e përmbushjes me sukses të kontratës ka kërkuar kriterë ekonomike si bilancet, vertetim xhiro, dhe kriter profesional paraqitjen e kontratave të ngjashme të realizuara 3 vitet e fundit.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e pajustificuar, diskriminues dhe është i vendosur në kundërshtim me Nenin 2 dhe 3 të LPP, pasi nuk siguron nxitjen e konkurrencës dhe nuk siguron trajtim të barabartë të operatorëve në tender.

Si konkluzion, kërkohet heqjen e autorizimit të prodhuesit/ distributorit pasi nuk është argumentuar drejt nga AK dhe nuk ka asnjë lidhje mes autorizimit dhe cilësisë së mallit të furnizuar.

2-Artikulli Nr. 42 “Pomp e dozimit dhe seti i injektimit të klorit”, përcaktuar në shtojcën 5 është një pajisje industriale dhe si e tillë nuk ka asnjë lidhje me artikujt e tjerë objekt prokurimi të cilët janë aparate dhe reagentë. Vendosja e kësaj pajisje në tërësinë e artikujve objekt prokurimi pengon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të specializuar në fushën e reagentëve dhe pajisjeve laboratorike.

Kodi CPV i cituar në procedurën e prokurimit është Reagente Kimike 33696300-8, e cila nuk e përfshin pajisjen e sipërcituar.

Sipas VKM nr. 457 datë 30.07.2021 “Miratimin e fjalorit të përbashkët të prokurimit” **Pomp dozimi** ka kodin CPV 42122230-1.

Bazuar në argumentimin e mësipërm, kërkohet që kjo pajisje të prokurohet si LOT me vete.

3-Në shtojcën 5 “formulari i Specifikimeve Teknike” të dokumenteve të procedurës së prokurimit janë konstatuar specifikime të artikujve objekt prokurimi, të cilat bien ndesh me dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e prokurimeve publike si më poshtë vijon:

1. Në artikullin nr. 12 Test Nitrate N2/25 ka mosperputhje të modelit të testit të kërkuar N2/25 me diapazonin 0.5-18.0 mg/l NO3-N, 2.2-79.7 mg/l NO3. Ky diapazon matje i perket modelit të testit 14542. Testet e nitrateve me metoden N2/25 kanë diapazon matjeje 0.5-25.0mg/l NO3-N dhe 2.2-110.7 mg/l NO3.

Kërkohet të kryhen korrigjimet e nevojshme.

2. Në artikullin Nr. 16 Test Fosfori niveli i ulët P6/26 është përcaktuar gabim metoda e dhene P6/26. Kjo metode nuk ekziston, mendohet se është lapsus.

Kërkohet të ndryshohet metoda nga P6/26 në P6/25.

3. Në artikullin Nr. 28 Aparat për matjen e Klorit të lirë janë përshkruar specifikimet teknike si më poshtë:

28	Aparat për matjen e Klorit të lirë	<p>Për matjen e klorit të lirë. (Aparati duhet të jetë i përshtatshëm për reagentet e PF-3 ose ekuivalent)</p> <p>Dedektori: Fotodiode silikoni.</p> <p>Lloji i kyvetes 1" e rrumbullakët 16mm ,rrumbullakët me adaptor</p> <p>Vlerësimi i papërshtueshëm nga uji : IP 67. Kushtet e funksionimit: 10 - 40 °C maksimumi. Lagështia relative max 90%</p> <p>Mënyra e funksionimit: Transmetimi (%), Absorbimi dhe Përqendrimi</p> <p>Sistemi optik: Transmetim 0 / 180 °</p> <p>Saktësia fotometrike: ± 0,03 Abs Lineariteti fotometrik: ± 0,002 Abs (0 - 1 Abs) Gama matjes fotometrike: 0-2 Abs Riprodhueshmëria: ± 0,005 Abs (0 - 1 A)</p> <p>Burimi i dritës: Diodë që lëshon dritë (LED) Gjerësia e brezit spektral 15nm</p> <p>Drita e humbur: < 1.0 % at 400 nm Temperature range: 0 - 50 °C Saktësia e gjatësisë së vales: ± 1 nm Fushe e gjatësisë së vales: 420, 520, 560, 610 nm Zgjedhja e gjatësisë së vales: Në mënyrë automatike</p>	Cope	1
----	------------------------------------	--	------	---

Specifikimet teknike të vendosura janë të aparatit DR900 e cila prodhohet nga Kompania HACH, e cila ka si distributor zyrtar ALBUJI sh.p.k. Bashkëngjitur do të gjeni katalogun zyrtar të HACH ku shihet qartë përputhja me këto specifikime.

Hartimi i këtyre specifikimeve është haptazi në kundërshtim me nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 LPP-së “4.Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo process i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregëtare, patente, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipermarrjeve ose produkteve”.

Autoriteti Kontraktor duhet të vërtetojë që specifikimet teknike duhet të plotësojnë të paktën dy prodhues dhe duhet të deklarojë emrat e tyre në mënyrë që të hedhë poshtë pretendimet tona.

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor të na ofrojë prodhuesin e dytë të tyre.

4. Në artikullin nr. 29 Aparat për matjen e TDS & pH për ujin e pijshëm janë përshkruar specifikimet si më poshtë:

29	Aparat për matjen e TDS & pH për ujin e pijshëm	<p>Aparature e certifikuar CE</p> <p>Eksport të të dhënave: me lidhje USB me kompiuter ose paisje USB</p> <p>Ruajtja e të dhënave: 10,000 të dhëna</p> <p>Dimensionet (L x Gj x Gj): 63 mm x 97 mm x 220 mm</p> <p>Ekrani: Deri në 3 parametra në të njëjtën kohë</p> <p>Lloji i ekranit: 536x336 Mono-TFT</p> <p>Klasifikimi për depertushmerinë e ujit: IP67</p> <p>Lagështira e ambientit: 90%</p> <p>Kushtet e punës: 0 - 60 °C</p> <p>Parameterat: pH, konduktivitetin</p> <p>Fusha e matjes e pH: 0 - 14 pH</p> <p>Resolucioni i pH që zgjidhet: 0.001/0.01/0.1 pH</p> <p>Fushe e matje e konduktivitetit: 0.00 mg/L - 50.0 g/L NaCl</p> <p>Me kompensim automatik të temperaturës për pH</p>	Cope	1
----	---	---	------	---

Specifikimet teknike të përmendura janë ato për aparatën HQ2100 e cila prodhohet nga kompania HACH e cila ka si distributor zyrtar në Shqipëri ALBUJI sh.p.k. Specifikimet e kërkuara janë shumë të detajuara me elemente të panevojshëm në lidhje me funksionin e këtij aparati.

Autoriteti Kontraktor duhet të hartojë specifikime teknike gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktor për të dorëzuar autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar, i cili në këtë rast është HACH si kompani prodhuese dhe ALBUJI sh.p.k. si distributor dhe përcaktimi i specifikimeve teknike të cilat çojnë drejt një prodhuesi dhe një distributori shkel pikërisht parimin e barazisë dhe konkurrencës së drejtë mes operatorëve ekonomikë.

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor të na informojë cilet janë prodhuesit e tjerë që plotësojnë specifikimet e kërkuara. Kërkojmë të ndryshohen specifikimet në mënyrë që të plotësohen të paktën nga 2-3 prodhues të tjerë që të lejohet pjesëmarrja e të gjithë operatorëve të interesuar.

5. Në artikullin Nr. 30 Aparat për matjen e turbullshmerisë për ujin e pijshëm janë përshkruar specifikimet si më poshtë:

30	Aparat për matjen e turbullshmerisë për ujin e pijshëm	<p>Saktësia: $\pm 2\%$ e leximit dhe dritës së humbur. Aparaturë e certifikuar CE Kuveta: 25 mm x 60 mm e rrumbullakët Ruan 500 rekorde Dimensionet (L x Gj x Gj): 77 mm x 107 mm x 229 mm Madhësia e ekranit: 240 x 160 pixels Lloji i ekranit: Graphic LCD Vlersimi i përshkrueshmërisë nga uji: IP67 Interface: Optional USB Burimi i dritës: Llampe me filament Tungsteni Lageshtira maksimale e punës: 90 % Measuring range: 0 - 1000 Njesia e matjes: NTU Temperatura e punimit: 0 - 50 °C Përsëritshmëria: $\pm 1\%$ e leximit ose 0.01 NTU , cilado qofte me e larte Koha e reagimit: 6 s në programimin normal të punës Vëllimi i mostres: 15 ml</p>	Cope	1
----	--	--	------	---

Specifikimet teknike të cituara janë ato të aparatit 2100Q e cila prodhohet nga kompania HACH e cila ka si distributor në Shqipëri ALBUJI sh.p.k.

Në respekt të parimit të trajtimit të barabartë, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojë/përfshijë nga konkurrenca operatorët ekonomikë ofertues ose prodhues. Në

hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Kërkojmë të ndryshohen specifikimet në mënyrë që të plotësohen të paktën nga 2-3 prodhues të tjerë që të lejohet pjesëmarrja e të gjithë operatorëve të interesuar në këtë procedurë të tenderimit.

6. Në artikullin Nr. 42 Pomp e dozimit dhe seti i injektimit të klorit janë cituar specifikimet si më poshtë:

42	Pomp e dozimit dhe seti i injektimit të klorit	<p>Presioni maksim i moskthimit 4 bar Vëllimi maksimal i injektimit 49 l/ore Numri maksimal impulseve 200/min Vëllimi i një impulsi 4.08 ml Ekran me ndërcim 3" ; pamje 3-LED për funksionimin, mesazhe paralajmëruese si dhe gabimet dhe që shihet nga të tre anët Në programimin manual pulsimit mund të vendosen nga 1 impuls/h deri në 12.000 impulse/h Gjatesia e impulsit mund të vendoset elektronikisht nga 0-100% Impulset mund të gradohen në mënyrë të ndryshme duke rritur dhe zvogëluar kohën e tyre si dhe në mënyrë rritëse dhe zvogëluar. Faktori për kontrollin e kontaktit nga jashtë 99:1-1:99 ; Gradim në AUT në shkallë më të vogël se 1 ml Mundësi lidhje me 2 çelës nivel 3 porta shtesë për hyrje/dalje dixhitale</p>	Cope	1
----	--	---	------	---

Specifikimet teknike për këtë pompë janë të pompë dozimi GXLa 0450 që prodhohet nga kompania ProMinent e cila ka gjithashtu distributor në Shqipëri ALBUJI sh.p.k. Bashkëngjitur do të gjeni katalogun zyrtar të ProMinent si dokument provues.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktor për të dorëzuar autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar, i cili në këtë rast është ProMinent si kompani prodhuese dhe ALBUJI si distributor dhe përcaktimi i specifikimeve teknike të cilat cojnë drejt një prodhuesi dhe një distributori shkel pikërisht parimin e barazisë dhe konkurrencës së drejtë mes operatorëve ekonomikë.

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktor të na informojë cilët janë prodhuesit e tjerë që plotësojnë specifikimet e kërkuara. Kërkojmë të ndryshohen specifikimet në mënyrë që të plotësohen të paktën nga 2-3 prodhues të tjerë në mënyrë që të lejohet pjesëmarrja e të gjithë operatorëve të interesuar.

Komisioni i Prokurimit Publik në shumë vendime të tij ka cituar që është shumë e rëndësishme që përmes specifikimeve teknike autoriteti kontraktor të mundësojë konkurrim të drejtë, të hapur, gjithpërfshirës të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë si dhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh.

11

Gjithashtu në vendimin e GJED, në çështjen Komisioni European vs Mbreteri e Holandës” ka arsyetuar se “*Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publikë duhet të lejojnë prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim duhet të jetë e mundur të dorëzohen tendera që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, edhe kur referimi bëhet në Standartin European ose në standartin kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritet kontraktuese*”

Për sa më sipër, konstatojmë së specifikimet teknike të të parashikuara në shtojcën 5 “ formulari i specifikimeve teknike” bien në kundërshtim të hapur me ligjin nr.162/2020 dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Standartet kombëtare dhe ato ndërkombëtare referojnë që Autoriteti Kontraktues duhet të hartojë specifikime teknike që lejojnë konkurrim të hapur, të drejtë, të barabartë dhe jo diskriminues. Ashtu sic edhe e përmendëm më sipër, specifikimet nuk kanë këtë qëllim, duke favorizuar kompani dhe pajisje konkrete të cilat nuk lejojnë pjesmarrjen e të gjithë operatorëve ekonomike të interesuar.

Në konkluzion të konstatimeve të mësipërme, kërkojmë riformulimin e të specifikimeve teknike në përputhje me kërkesat ligjore. Për pretendimet tona gjeni bashkëngjitur kataloget e kompanise prodhuese HACH dhe PRO MINENT, si dhe website-in e kompanise Albuji sh.p.k. ku vërtetohet se është distributori zyrtar ne Shqipëri i Hach dhe ProMinent.

5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme

Po	Jo
<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>

(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)

6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:

7. Lista e informacionit konfidencial:

Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.

Kujdes :Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

Nr. i faksit:

E-mail: info@krijon.al

Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit:

Shoqëria “Krijon” sh.p.k
Piro ZOGA
Administratori



Model	Measurement range (max. specification)	Cuvette (mm)1) depending on photometer	ml	Order No.	Total	CC	SW	photoLab®			pHotoFlex®
								S6	S12	6000/7000	
09713/2	0.10 - 25.0 mg/l NO ₃ -N 0.40 - 110.7 mg/l NO ₃	10, 20, 50	0.5	252085	250	✓	-	-	●	●	-
TC NO ₃ -1 TC	0.2 - 30.0 mg/l NO ₃ -N 1 - 133.0 mg/l NO ₃	16	1	251993	50	-	-	-	-	●	●
Nitrite NO₂											
N5/25	0.010 - 0.700 mg/l NO ₂ -N 2.2 - 2.30 mg/l NO ₂	16	5	252074	25	-	✓	●	●	●	●
14776/1	0.002 - 1.00 mg/l NO ₂ -N 0.007 - 3.28 mg/l NO ₂	10, 20, 50, 16, 28	5	250445	1000	-	✓	-	●	●	●
14776/2	0.002 - 1,000 mg/l NO ₂ -N 0.007 - 3.28 mg/l NO ₂	10, 20, 50, 16, 28	5	250440	335	-	✓	-	●	●	●
00609	1.0 - 90.0 mg/l NO ₂ -N 3.3 - 295.2 mg/l NO ₂	16	8	252069	25	-	-	●	●	●	-
TP NO ₂ -1 TP	0.002 - 0.300 mg/l NO ₂ -N 0.007 - 0.985 mg/l NO ₂	20, 28	10	251409	100	-	-	-	-	●	●
TC NO ₂ -2 TC	0.03 - 0.60 mg/l NO ₂ -N (LR) 0.10 - 1.97 mg/l NO ₂ -N (LR) 0.30 - 3.00 mg/l NO ₂ -N (HR) 0.99 - 9.85 mg/l NO ₂ -N (HR)	16	2	251994	24	-	-	-	-	●	●
		16	0.5								
TP NO ₂ -3 TP	0.002 - 0.300 mg/l NO ₂ -N 0.007 - 0.985 mg/l NO ₂	20, 28	25	251419	100	-	-	-	-	●	●
Nitrogen (total): see total nitrogen N_{ges}											
Organic acids (volatile)											
01749	50-3000 mg/l	round	0.5	252096	25	-	-	●	●	●	-
01809	50-3000 mg/l (100 °C, 15 min.)	16	0.5	252095	100	-	-	●	●	●	-
Oxygen capacity up to pH 4.3											
01758	KS _{4,3} 0.40 - 8.00 mmol/l 20 - 400 mg/l CaCO ₃	16	1	252087	120	-	-	●	●	●	●
Oxygen O₂											
14694	0.5 - 12.0 mg/l O ₂	16	-	250403	25	-	-	●	●	●	-
Ozone O₃											
00607/1	0.010 - 4.00 mg/l O ₃	10, 20, 50, 16, 28	10	252016	200	-	-	-	●	●	●
00607/2	0.010 - 4.00 mg/l O ₃	10, 20, 50, 16, 28	10	252054	1200	-	-	-	●	●	●
pH											
01744	pH 6.4 - 8.8	16	10	252050	280	-	✓	●	●	●	-
Phenol C₆H₅OH											
00856	0.002 - 0.100 mg/l C ₆ H ₅ OH 0.025 - 5.00 mg/l C ₆ H ₅ OH	20	200	252058	50 250	-	✓	-	●	●	-
		10, 20, 50	10								
14551	0.10 - 2.50 mg/l C ₆ H ₅ OH	16	10	250412	25	-	✓	-	●	●	●
Phosphate PO₄											
P6/25	0.05 - 5.00 mg/l PO ₄ -P 0.05 - 5.0 mg/l P _{ges} 0.2 - 15.3 mg/l PO ₄	16	5	252075	25	✓	✓	●	●	●	●

● = round cuvette test; TC = cuvette test; CC = CombiCheck; ml = sample volume (photoLab®); 1) ○ 16, 28
 ■ = reagent tests; TP = powder test; SW = sea water; □ 10, 20, 50



DR900 Robust portable datalogging colorimeter



Product #: 9385200
 Unit Price [Contact Us](#)
 Available

Rugged construction

Dustproof, waterproof, shockproof

Designed for use in the field

True handheld analysis for use anywhere

Easy to use

Menu driven, step-by-step analysis

Reliable results without a main connection

Improved user interface allowing quick selection of tests

Configured for immediate use

Pre-programmed, ready to use "out of the box"

What's in the box

Includes: DR900 instrument, USB cable with mini-USB connector, 4-AA alkaline batteries, 2 glass sample cells 1-inch (25 mm) round with 10, 20, 25-mL marks, 2 sample cells 1 cm/10 mL, sample cell adapter and multilingual user manual

Specifications

Battery life:	6 months (typical) at 5 readings a day / 5 day week without backlight (backlight usage will decrease battery life)
Battery requirements:	4 AA size batteries
Cuvette compatibility:	1 inch round / 16 mm round (with adapter)
Detector:	Silicon photodiode
Dimensions (H x W x D):	231 mm x 96 mm x 48 mm
Display:	Graphical display 240 x 160 pixel (Backlit)
Enclosure waterproof rating:	IP67
Environmental conditions: relative humidity:	Max. 90 % relative humidity (non-condensing)
Environmental conditions: temperature:	10 - 40 °C
Interface:	USB type Mini IP67
Manual languages:	English, French, German, Italian, Spanish, Portuguese, Bulgarian, Chinese, Czech, Danish, Dutch, Finnish, Greek, Hungarian, Japanese, Korean, Polish, Romanian, Russian, Slovenian, Swedish, Turkish
Operating conditions:	10 - 40 °C (50 - 104 °F), max. 80 % relative humidity (non- condensing)
Operating mode:	Transmittance (%), Absorbance and Concentration
Optical system:	0 / 180 ° transmittance
Photometric accuracy:	± 0.03 Abs
Photometric linearity:	± 0.002 Abs (0 - 1 Abs)
Photometric measuring range:	0 - 2 Abs

Reproducibility:	± 0.005 Abs (0 - 1 A)
Source lamp:	Light Emitting Diode (LED)
Spectral Bandwidth:	15 nm filter bandwidth
Storage conditions:	-30 - 60 °C (-30 - 140 °F), max. 80 % relative humidity (non-condensing)
Stray light:	< 1.0 % at 400 nm
Supported chemistry:	Hach tests
Temperature range:	0 - 50 °C
User interface:	English, French, German, Italian, Spanish, Portuguese, Bulgarian, Chinese, Czech, Danish, Dutch, Finnish, Greek, Hungarian, Japanese, Korean, Polish, Romanian, Russian, Slovenian, Swedish, Turkish
User programmes:	10
Warranty:	24 months
Wavelength accuracy:	± 1 nm
Wavelength range:	420, 520, 560, 610 nm
Wavelength selection:	Automatic
Weight:	0.6 kg with battery
What's included?:	Includes: DR900 instrument, USB cable with mini-USB connector, 4-AA alkaline batteries, 2 glass sample cells 1-inch (25 mm) round with 10, 20, 25-mL marks, 2 sample cells 1 cm/10 mL, sample cell adapter and multilingual user manual

17



HQ2100 Portable Multi-Meter pH, Conductivity, TDS, Salinity, Dissolved Oxygen (DO), and Oxidation Reduction Potential (ORP)



Product #: LEV015.97.2100A

Unit Price [Contact Hach](#)

Performing a successful calibration has never been so simple

Most measuring issues are due to incorrect calibration procedures. With our illustrated, step-by-step on-screen calibration and troubleshooting procedures, water quality professionals can succeed every time.

Deliver your daily activity in just a few clicks

Whether you are at your facility or working in the field, the Hach® HQ Series portable meter ensures your data will be safely transferred via USB.

Sensors designed for every application

